



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 185/13

Nr. i fq. / Br. sh - 6 -

Data: / Datum 25.07.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS**

KORRIK 2013

Bazuar në nenin 12 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 41.2 "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2013, miraton këtë:

RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË DHE SHPËRBLIMEVE PËR NXËNËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1.1. Me këtë rregullore themelohet baza juridike për ndarjen e bursave nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, për nxënësit e shkollave të mesme të larta, studentët e nivelit baçelor dhe master.

1.2. Caktohen kategoritë përfituese dhe rregullohet mënyra e dhënies së bursave.

Neni 2
Fushëveprimi

2.1. Përfitues të bursave janë: studentët me kushte të rënda socio-ekonomike, studentët e nivelit baçelor dhe master, të cilët studiojnë brenda vendit, e që janë banorë të Komunës së Vushtrrisë.

2.2. Përfitues të shpërblimeve janë: nxënësit e shkollave të mesme të larta, të cilët kanë arritur rezultate të mira në nivel komunal, regjional dhe shtetëror.

Neni 3
Përkufizimet

3.1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

3.1.1. **Shpërblim për nxënës**- nënkupton shpërblimin e dhënë në të holla pa kthim, që Komuna e Vushtrrisë e ndanë nxënësit e shkollave të mesme të larta, të cilët kanë arritur rezultate të mira;

3.1.2. **Bursë studimi**- nënkupton ndihmën e dhënë në të holla pa kthim që Komuna e Vushtrrisë e ndanë për studentët e nivelit baçelor dhe master;

3.1.3. **Ndërprerja e bursës**- nënkupton marrjen e të drejtës së përfituesit të bursës nga Komuna e Vushtrrisë, kur autoritetet e komunës konstatojnë se dhënia e bursës është në kundërshtim me këtë rregullore.

3.1.4. **DA**- nënkupton Drejtorinë për Arsim.

KREU II
DISPOZITAT KRYESORE

Neni 4
Llojet e bursave

4.1. Llojet e bursave sipas kësaj rregulloreje janë:

4.1.1. Bursa studimi për studentë me notë të lartë mesatare,

4.1.2. Bursa studimi për studentë me gjendje të rëndë ekonomike,

- 4.1.3. Bursa studimi për studentë, fëmijë të dëshmorëve,
4.1.4. Bursa studimi për studentë, fëmijë të invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së,
4.1.5. Bursa studimi për studentë, fëmijë të martirëve dhe ish të burgosurve politikë.

Neni 5

Shpërblim për nxënës

- 5.1. Përfitues të këtij shpërblimi janë nxënësit e mësimit të rregullt, me gjendje të rëndë socio-ekonomike, nxënësit dhe nxënëset e viseve rurale që nuk kanë mundësi shkollimi e që i vijnë mësimit në shkollat publike të Kosovës;
5.2. Dhënia e bursave për këtë kategori fillon nga klasa e dhjetë.

Neni 6

Bursa për studentë me notë të lartë mesatare

- 6.1. Përfitues të kësaj burse janë studentët më të mirë që zgjidhen në garën me notë mesatare më të lartë se tetë, në konkurrencë të kësaj kategorie për numrin e bursave që ndanë komuna;
6.2. Në konkurrencë të njëjtë përparësi kanë studentët e universiteteve publike;
6.3. Dhënia e bursave për nivelin baçelor fillon nga viti i dytë i studimeve, ndërsa për ata master nga viti i parë;
6.4. Nga përfitimi i bursës së këtyre kategorive përjashtohen studentët që janë në marrëdhënie pune apo që marrin edhe bursë tjetër.

Neni 7

Bursa për studentë me gjendje të rëndë ekonomike

- 7.1. Përfitues të kësaj burse janë studentët me gjendjen më të rëndë socio-ekonomike në konkurrencë të kësaj kategorie, për numrin e bursave që ndanë komuna;
7.2. Përparësi kanë studentët me gjendje të rëndë socio-ekonomike, që jetojnë me qira dhe ata me aftësi të kufizuara.

Neni 8

Bursa studimi për fëmijë të dëshmorëve

Përfitues të kësaj burse janë studentët, fëmijë të dëshmorëve, të cilët studiojnë në nivelin baçelor dhe master në universitete publike dhe kolegje private në Republikën e Kosovës.

Neni 9

Bursa studimi për fëmijë të invalidëve dhe të veteranëve të UÇK-së

- 9.1. Përfitues të kësaj burse janë studentët, fëmijë të invalidëve dhe të veteranëve të luftës së UÇK-së, studentë të nivelit baçelor dhe master, në universitete publike dhe kolegje private;
9.2. Përparësi kanë studentët me gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe ata pa strehim të përhershëm.

Neni 10

Bursa studimi për fëmijë të martirëve dhe ish të burgosurve politikë

- 10.1. Përfitues të kësaj burse janë studentët, fëmijë të martirëve të rënë në luftën e UÇK-së, si dhe studentët, fëmijë të ish të burgosurve politikë;

10.2. Përparësi kanë fëmijët me kushte të rënda socio-ekonomike dhe ata pa përkujdesje.

Neni 11

Përfituesit e bursave

- 11.1. Përfitues të bursave janë të gjitha kategoritë, të cilët i plotësojnë kriteret nga neni 5 deri të neni 10 i kësaj rregulloreje;
- 11.2. Bursat ndahen për 12 muaj, (për periudhën kohore 1 tetor -30 shtator, të vitit vijues akademik);
- 11.3. Mund të përfitojnë bursa vetëm studentët, të cilët vijnë shkollim-studime të rregullta;
- 11.4. I ndërpritet bursa studentit për të cilin vërtetohet se merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore dhe i njëjti obligohet ta kthejë bursën e komunës;
- 11.5. Prej një familjeje mund të marrë bursë vetëm një student për një vit shkollor-akademik;
- 11.6. Studenti që vazhdon me plotësimin e kriterëve sipas kësaj rregulloreje, i vazhdohet bursa edhe për vitet vijuese;
- 11.7. Nuk përfitojnë bursë kategoritë nga neni 5 deri te neni 10:
 - 11.7.1. Studentët që janë në marrëdhënie pune;
 - 11.7.2. Studentët që janë të liruar nga pagesa në kolegjet private;
 - 11.7.3. Studentët që janë duke përfituar bursë tjetër;
 - 11.7.4. Studentët për vitin e përsëritur;
 - 11.7.5. Studentët që janë të regjistruar si studentë me korrespondencë.

Neni 12

Planifikimi i mjeteve për bursa

- 12.1. Kuvendi i Komunës, çdo vit fiskal, me miratim të buxhetit planifikon edhe shumën e caktuar të mjeteve për bursa dhe numrin e bursave për të gjitha kategoritë nga neni 5 deri të neni 10 i kësaj rregulloreje duke caktuar:
 - 12.1.1. Numrin e bursave për vitin shkollor-akademik për secilën kategori të kësaj rregulloreje;
 - 12.1.2. Shumën e mjeteve për muaj, për secilën kategori, duke marrë për bazë standardet e jetesës;
 - 12.1.3. Drejtimet deficitare.

Neni 13

Shpallja e konkursit për bursa

- 13.1. DA-ja shpall konkursin për bursa, si dhe bën administrimin e të gjitha procedurave tjera si:
 - 13.1.1. Cakton kohën e shpalljes dhe afatin e konkurrimit, duke marrë për bazë kalendarin e fillimit të vitit shkollor dhe vitit akademik;
 - 13.1.2. Cakton vendin e dhënies së aplikacioneve dhe të pranimit të dokumenteve;
 - 13.1.3. Vendos kriteret për konkurrim për secilën kategori, në harmoni me këtë rregullore;
 - 13.1.4. Cakton orarin e pranimit të dokumenteve, si dhe udhëheq të gjitha procedurat e tjera teknike dhe administrative të konkurrimit;
 - 13.1.5. Bën shpalljen përmes konkursit publik në tabelën e publikimeve, në Web-faqe të komunës, në njërin nga gazetatat ditore dhe në një radio lokale;

13.1.6. Informon se afati për aplikim është 15 ditë nga dita e shpalljes deri në orën 16:00 të ditës së fundit, por nëse dita e fundit apo më shumë ditë janë ditë pushimi për administratë, konkursi shtyhet për aq ditë në ditët e ardhshme të punës.

Neni 14

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

14.1. Kërkojnë këto dokumente për konkurrim për bursa:

14.1.1. Dëshmi e regjistrimit të klasës;

14.1.2. Certifikatë e provimeve të dhëna së bashku me kopjen e indeksit;

14.1.3. Deklaratë e bashkësisë familjare;

14.1.4. Dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit të luftës, martirit të luftës, i ish të burgosurit politik, është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja me gjendje ekonomike-sociale;

14.1.5. Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, në lëmin arsimor;

14.1.6. Dokumente të tjera të nevojshme për konkurrim që i kërkon DA-ja.

Neni 15

Komisioni për ndarje të bursave

15.1. Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit ad-hoc, tre-anëtarësh për ndarje të bursave;

15.2. Kryetar i komisionit emërohet drejtori ose përgjegjësi i DA-së, anëtar i dytë emërohet një zyrtar i DA-së, ndërsa anëtar i tretë një jurist me përvojë nga administrata e komunës;

15.3. Komisioni mblidhet me ftesën e kryetarit të komisionit, më së largu 5 ditë nga mbyllja e konkursit;

15.4. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara në konkurs, eliminohen nga gara;

15.5. Përzgjedhja e kandidatëve për secilën kategori, bëhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;

15.6. Komisioni vendos me shumicë të votave për ndarjen e bursave;

15.7. Pas përfundimit të përzgjedhjes, jo më larg se 5 ditë nga dita e mbledhjes, komisioni i publikon rezultatet në tabelë të shpalljeve dhe në web-faqe të komunës, e shkruan dhe e nënshkruan raportin e punës së komisionit dhe ia dërgon kryetarit të komunës;

15.8. Pas kalimit të afatit për ankesa, komisioni i fton përfituesit e bursave dhe nënshkruan kontratë me ta;

15.9. Kontrata është njëvjeçare, me mundësi vazhdimi pa iu nënshtruar konkursit, për studentë përfitues të bursës që i përmbushin kriteret sipas kësaj rregulloreje;

15.10. Kontrata nuk merr obligim punësimin e bursistëve pas mbarimit të shkollimit-studimeve;

15.11. Kontrata obligon bursistët t'i përgjigjen DA-së, sa herë që DA-ja kërkon dokumente që përcjellin nivelin, vijueshmërinë dhe cilësinë e mësimeve-studimeve;

15.12. Komisioni në fjalë e informon Kuvendin e Komunës për tërë procesin e ndarjes së bursave.

Neni 16
Procedurat e ankesave

- 16.1. Çdo kandidat i pakënaqur me rezultatin e komisionit për ndarje të bursave, gëzon të drejtën e ankesës tek komisioni i ankesave, brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore;
- 16.2. Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit ad-hoc tre-anëtarësh, për shqyrtimin e ankesave, njërin nga anëtarët e këtij komisioni e emëron kryetar;
- 16.3. Anëtarët e emëruar të komisionit janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë), nga të cilët një jurist, një zyrtar nga DA-ja dhe i treti po ashtu nga administrata;
- 16.4. Nuk mund të jenë anëtarë të këtij komisioni, anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në ndarje të bursave;
- 16.5. Vendimi për emërimin e komisionit publikohet në web-faqe të komunës dhe në tabelë të shpalljeve;
- 16.6. Komisioni është autoritet vendimmarrës, përfundimtar i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve;
- 16.7. Vendimet në emër të komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit;
- 16.8. Çdo vendim shkruhet në 4 kopje në origjinal;
- 16.9. Një kopje i dërgohet kryetarit të komunës, një komisionit për ndarje të bursave, një palës që është ankuar dhe një vendim arkivit të komunës;
- 16.10. Afati për ankesa është 8 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve për përfitues të bursave;
- 16.11. Në vendim jepet dhe arsyetimi.

Neni 17
Dispozitat kalimtare

- 17.1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë sipas procedurave për miratimin e akteve normative;
- 17.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurave të njëjta për miratimin e saj.

Neni 18

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa
Habib Mustafa